



KOMUNIKATË

11.02.2010

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbajti sot mbledhjen e 15-të me radhë. Para se të miratohej rendi i ditës, kryetarja e KQZ-së znj. Nesrin Lushta, kërkoi që të mbahet një minutë heshtje në shenjë nderimi për anëtarin e KQZ-së Xhelil Pajaziti, i cili vdiq më 7 shkurt. Kryetarja Nesrin Lushta, falenderoi në emër të KQZ-së të gjitha ata që kanë dërguar telegrame ngushëllimi: ambasadorin e OSBE-së z. Almhofer, IFES-in, Komisionin dhe Zgjedhjeve të Maqedonisë.

Në vazhdim të mbledhjes, anëtari i KQZ-së z. Fadil Maloku, pyeti se pse “Gjilani” ende s’është në agjendë të takimeve të KQZ-së. Kryetarja Nesrin Lushta, tha se kjo ndodhë për shkak se në Gjykatën Supreme janë dy ankesa lidhur me këtë rast, e të cilat ende nuk janë përfunduar.

Kryetarja Nesrin Lushta, e informoi KQZ-në se në bazë të kërkesës së saj të bërë më 10 shkurt 2010, Gjykata Kushtetuese ka njoftuar se deri më 10 shkurt 2010 (ora 14.15), në këtë gjykatë nuk ka ardhë asnjë kërkesë lidhur me zgjedhjet e përsëritura për kryetar të komunave të Lipjanit dhe Prizrenit.

Gjithashtu, edhe KZAP-i përmes një shkrese të dërguar më 9 shkurt, ka konfirmuar se bazuar në juridiksionin e KZAP-it për shqyrtimin e ankesave dhe parashtresave, KZAP ka marrë vendim në lidhje me të gjitha ankesat dhe parashtresat valide që kanë të bëjnë me zgjedhjet për Kryetar të Komune në Prizren dhe Lipjan, dhe që do të mund të kishin afektuar rezultatin përfundimtar të këtyre komunave. Sa i përket KZAP-it, bazuar në nenin 106. 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, KQZ mund t’i certifikoj rezultatet për zgjedhje në lidhje me Kryetarët e Komunës së Prizrenit dhe të Lipjanit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendim unanim, i certifikoi rezultatet e rivotimit për kryetar të komunës së Prizrenit dhe të Lipjanit që u mbajtën më 31 janar.